



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.04.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-2985/15, për z. Blerim Krasniqi – Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në Postën e Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur pas një informacioni të deponuar në Agjencinë kundër Korrupsionit, nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-2985/15, për z. Blerim Krasniqi – Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në Postën e Kosovës, është mbyllur për shkak se nuk qëndrojnë pretendimet e palës denoncuese .

Dyshimet për konflikt interesi kanë qenë sepse, sipas denoncuesit të rastit, në rastin e Auditimeve të brendshme në ndërmarrjen Posta e Kosovës ekziston konflikt interesi sepse Auditori i Brendshëm në këtë ndërmarrje, deri në momentin kur është zgjedhur Auditor, ka qenë Drejtor i Financave në këtë ndërmarrje dhe kjo praktikisht i bie që ai të auditoj shumë projekte për të cilat z. Krasniqi ka qenë i implikuar direkt si nënshkrues i pagesave.

Auditori i Postës ka qenë edhe U.d. Drejtor i Postës së Kosovës dhe pas përfundimit të këtyre mandateve i njëjti është zgjedhur auditor i brendshëm në këtë ndërmarrje. Sipas denoncuesit, kjo paraqet konflikt interesi bazuar në Ligjin e Auditimit të Brendshëm. Në nenin 17 (pikla 3) thuhet:

3. Konflikti i interesave ekziston nëse auditimi përfshin apo ka të bëjë me:

3.1. subjektin e sektorit publik në të cilin Auditori i Brendshëm ka qenë i punësuar ose i angazhuar në çfarëdo kapaciteti tjetër përveç si Auditor i Brendshëm sipas këtij ligji, në tri vitet e fundit;

Pas pranimit të këtyre informacioneve, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar takim.

Në takim z. Krasniqi ka deklaruar se në momentin që është zgjedhur në pozitën e Auditorit të brendshëm i ka pasur parasysh këto dispozita, mirëpo nga ajo kohë Posta dhe Telekom i Kosovës funksionojnë si të vetme. Ai ka thënë se të gjitha projektet në të cilat ka qenë pjesë tani kanë kaluar në Telekomin e Kosovës dhe rrjedhimisht ai nuk ka qenë pjesë e auditimit të brendshëm. Kjo është konfirmuar edhe nga zyrtarët e Postës së Kosovës pas kërkesës së AKK-së.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, si dhe dispozitat e lartcituara, vlerësojmë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit apo papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

